



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT
MINISTRI

U-POLIS
NR. 66/16. Prot.
Dt. 24.05.2016

Nr. 5239 Prot.

Tiranë, më 20.05.2016

URDHËR

Nr. 268, datë 20.05.2016

**"PËR
AKREDITIMIN PERIODIK TË PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË
DYTË, MASTER I SHKENCAVE I INTEGRUAR NË "ARKITEKTURË DHE
DIZAJN URBAN", TË FAKULTETIT "ARKITEKTURË DHE DIZAJN", TË
UNIVERSITETIT "POLIS"**

Në mbështetje të Nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 138 të Ligjit nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe Vendimit nr. 424, datë 28.4.2010 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullores për sistemin e akreditimit, organizimin dhe veprimtarinë e institucioneve të sigurimit të jashtëm të cilësisë", i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Akreditimin periodik të programit të studimit të ciklit të dytë, Master i Shkencave i Integruar në "Arkitekturë dhe Dizajn Urban", në Fakultetin "Arkitekturë dhe Dizajn", të Universitetit "Polis", që realizohet me 300 kredite, me formë studimi me kohë të plotë, me kohëzgjatje 5 vite akademike/10 semestra, në përfundim të të cilës lëshohet diplomë universitare "Master i Shkencave i Integruar" në "Arkitekturë dhe Dizajn Urban".
2. Ky program studimi akreditohet në bazë të Vendimit nr. 120, datë 18.02.2016, të Këshillit të Akreditimit të Arsimit të Lartë, bashkëlidhur këtij urdhri.
3. Ngarkohet Inspektorati Shtetëror për Arsimin dhe Ministria e Arsimit dhe Sportit për kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucion.
4. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm dhe Drejtorja e Arsimit të Lartë dhe Shkencës, në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë dhe Universiteti "Polis".

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në "Fletoren Zyrtare"

LINDITA NIKOLLA

MINISTËR

